



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.229/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi Kryesues, Hajriz Hoti dhe Kujtim Pasuli, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me 30.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.229/2025 e datës 27.01.2025
- II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 4,000.00 (katërmijë) euro.
- III. Detyrohet Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 27.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me të cilën pretendon se më 27 Janar 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje, në Istog ka identifikuar baner/poster të vendosur në hapësirat/rrugët publike të kandidatit për deputetë të LDK-së Lumir Abdixhiku, në rrugën publike "Lidhja e Pejës", në fshatin Banjë të Istogut, ky baner është vendosur në shtyllë ndriçuese dhe elektrike, ku me këtë veprim kandidati dhe subjekti politik LDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP. Më tutje parashtresuesi i ankesës ka theksuar se përmes këtij veprimi subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore, andaj duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, gjithashtu bazuar tashmë në praktikën e PZAP-së, mes tjerash me vendimet A.nr.65/2025, A.nr.58/2025, A.nr.48/2025, A.nr.49/2025, A.nr.50/2025, A.nr.51/2025, ka kërkuar që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si provë ka bashkangjitur fotografinë që dëshmonë vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

Më datë 28.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datën 29.01.2025 në ora 10:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 29.01.2025, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), theksohet se, në rastin e ankesës A.nr.229/2025, posterit i vendosur nuk ka të bëjë me ndonjë material zgjedhor të LDK-së apo ndonjë prej kandidatëve, sepse i njëjti nuk përmban as thirrjen për votim përmes logos zyrtare të partisë dhe numrit 124, as sloganin zgjedhor dhe në këtë rast nuk është e provuar nga ankuesi se e njëjta është vendosur nga subjekti politik dhe përmes përgjigjes në ankesë ka kërkuar nga PZAP që të marrë vendim meritator për rastin në fjalë, si dhe që ankesa e subjektit LVV të refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës gjeti se:

-Ankesa është e bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Në rastin konkret pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me kandidatin në fjalë janë të bazuara për shkak se i njëjti ka vendosur posterin në rrugën publike “Lidhja e Pejës”, në fshatin Banjë të Istogut, ky baner është vendosur në shtyllë ndriçuese dhe elektrike, pa Pëlqimin nga Organi Kompetent, dhe se veprimet e tilla paneli i konsideron si shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.


Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Pretendimi i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës në përgjigjen në ankesë se posteri i vendosur nga radhët e LDK-së nuk ka të bëjë me ndonjë material zgjedhor të LDK-së apo ndonjë prej kandidatëve, sepse i njëjti nuk përmban as thirrjen për votim përmes logos zyrtare të partisë dhe numrit 124, as slloganin zgjedhor ky pretendim është i pa bazuar, pasi që përmes fotos të ofruar si provë në ankesë, vërehet qartë kandidati për deputet i subjektit politik LDK, Lumir Abdixhiku me mbishkrimin “Lumir Abdixhiku, Mirë se vjen Kryeministër në Vatikanin e LDK-së”, i cili poster është vendosur në shtyllë ndriçuese dhe elektrike. Sa i përket lartësisë së dënimit, paneli pati parasysh faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës është përsëritës i shkeljeve të theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 229/2025 më datë 30.01.2025

Kryesuesi i Panelit
Ramush Bardiqi



Prishtinë / Pristina

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.